

Maj
2013

KODI I KANGJELLAVE


Bagazhi minimal i njohjes së realitetit brenda
dhe jashtë burgut



Provincia
Autonomee
Trentos

Këshilltarja e
Barazisë
gjinore

Departamenti
i Solidaritetit
Ndërkombëtar
e Bashkë-
jetesës



CONFERENZA REGIONALE VOLONTARIATO GIUSTIZIA
TRENTINO ALTO ADIGE

Mirëpritja me entuziazëm i botimit të parë të "*Codice a Sbarre*" (*Kodi i Kangjellave*) dhe modifikimet e bëra gjatë këtyre viteve në fushën legjislative e të organizimit territorial të shërbimeve, na kanë bindur të botojmë modelin e ri, të rishikuar e të azhurnuar të vademekumit tonë.

Për përgatitjen e këtij botimi kanë punuar me shumë dedikim dhe pa pagesë, vullnetarët e "*Avvocati për la Solidarietà*" (*Avokatët për solidaritet*) të Trentos e Roveretos (në veçanti: av. Nicola Canëstrini, av. Valentina Carollo, av. Giovanni Guarini) e av. Chiara Pontalti: për revizionimin nga ana juridike; ndërsa për koordinimin e botimit, sekretaria që përgjigjet për skedat e Provinces së Trentos, nën kujdesin e dott.ssa Rosina Cavallo dhe ajo e revizionimit të skedave të Provincës së Bolzanos, Sabina Sedlak; për përpunimin e tekstit dhe parapërgatitjen për stampim falënderojmë dott. Piacentino Claudio (shtëpia botuese) dhe dott.ssa Elena Tomè, ndërsa për materialin që u përket të burgosurve jo italian, falënderojmë dott.ssa Irenë Serangeli. Të gjithë këta i falënderojmë përzemërsisht për devoshmërinë me të cilin janë dedikuar këtij projekti. Pa ndihmën e tyre të vyer e konstruktive ky projekt editorial nuk do të kishtë parë kurrë dritën e botimit. I falënderojmë në emër të të gjithë vullnetarëve; ve e të gjithë personave: të burgosur apo të lirë, që do të kenë mundësinë të përdorin këtë vademekum.

Falënderojmë edhe Provincën e Trentos, në veçanti Komisioneren për Barazi Gjinore, dott.ssa Lia Giovannazzi Beltrami, e cila na ka mbështetur me dëshirën që kjo vepër të dalë në dritë, duke financuar botimin e saj.

Një falënderim të veçantë për "*Conferenza Regionale Volontariato Giustizia Liguria*" (*Konferenca Rajonale e Vullnetarizmit dhe Drejtësisë Ligure*), për dott. ssa Anna Grosso e Av. Marco Cafiero, që na kanë dhënë lehtë të përdorim tëkstin e vademekumit të tyre "*Vademecum dell'assistenti volontario nelle*

carceri" (*Vademekum për asistentët vullnetar në burgje*); që nga botimi i parë i vademekumit tonë.

Presidenti i "*Conferenza Regionale Volontariato Giustizia Trentino*" (*Konferenca Rajonale e Vullnetarizmit dhe Drejtësisë Trentino*) falënderon të gjithë, për punën e madhe që kanë bërë dhe për impenjimin e dedikimin me devotshmërinë në këtë projekt.

"Presidentë Conferenza Regionale
Volontariato Giustizia Trentino Alto Adige"
(*Presidenti i Konferencës Rajonale
të Vullnetarizmit të Drejtësisë Trentino*)
MICHELE LARENTIS

PËRMBAJTJE

Principet themelore të vullnetarizmit në burgje	
Konferenca Rajonale e Vullnetarizmit dhe Drejtësisë Trentin	8
Kujt i drejtohet vademekumi.	10
Pse vullnëtarizëm.	11
Pse vullnëtarizëm në burgje.	12
Pjesa I. "planeti burg"	16
1. Kuadri normativ	16
2. Institucionët ndëshkimore	18
3. Struktura e burgut	20
4. U.E.P.E. (Zyrat e Jashtme e Ekzekutimit Penale)	20
5. Personeli i burgut	22
6. Përsonat me liri të kufizuar	24
Pjesa II. Asistenti vullnetar i burgut	26
1. Roli i vullnetarizmit në burg (nën. 17, nën. 78)	26
Specifikat e vullnetarizmit në burg	26
Fushat e ndërhyrjes së asistentit vullnetar. ish neni.78	26
Pjesa III. Thellimi mbi bazat ligjore	29
1. Fazat rreth	29
a) Hetimet.	29
b) Avokati mbrojtës.	29
c) Prokurori	31
d) Gjykatësi për hetimet paraprake GIP	32
e) Gjykatësi për seancën paraprake GUP	32
f) Kufizimet e lirisë personale	32
g) Seanca e sanksionimit	34
h) Masat parandaluese	35
i) Gjykata për rishikim	36
l) Lirimi	37

2. Gjyqi	38
a) Seanca dëgjimore paraprake	38
b) Gjykim i zakonshëm	39
c) Ritët alternative	39
d) Ritët speciale	40
e) Gjyqi i apëlimit në Kasacion	42
f) Përsëritësit dhe Ligji, ish "Cirielli"	43
3. Faza e ekzekutimit	44
a) Figurat	45
b) Ligjet	46
c) Masat alternative, lejet dhe përfitimet e tjera.	
I burgosuri jo italian.	58
I burgosuri narkoman.	66
Pjesa IV. Monitorimi nga Rajoni Trentino Alto Adige	70
Provinca Autonome e Bolzanos	70
Provinca Autonome e Trentos	87

KUSHTËTUTA E REPUBLIKËS ITALIANË

ART. 27

*Përgjegjësia penale e personale
I pandehuri nuk konsiderohet fajtor deri në dënimin përfundimtar.
Dënimet nuk mund të jenë në kundërshtim me të drejtat e
dinjitetit njerëzor dhe duhet të synojë
riedukimin e të dënuarit*

RREGULLORJA E BURGJEVE

ART. 17

*Pjesëmarrja e komunitetit të jashtëm në punën riedukuese.
Qëllimi i rehabilitimit social i të burgosurve dhe internuarve duhet
të ndiqet edhe duke nxitur e organizuar pjesëmarrjen e privatëve
dhe*

*institucioneve apo shoqatave publike e
privatë në punën rehabilituese.*

*Do të pranohen të frekuentojnë burgjet, me fletëleje dhe sipas
direktivave të gjyqtarit për mbikëqyrjen; me miratimin e drejtorit,
të gjithë ata që konkretisht demonstrojnë interes në risocializimin
e të burgosurve; demonstrojnë gjithashtu që promovojnë në
mënyrë efektive zhvillimin e kontakteve midis komunitetit të
burgjeve
dhe shoqërisë së lirë.*

ART. 78

Asistentët vullnetar

*Administrata e burgut, me propozimin e gjyqtarit mbikëqyrës,
mund të autorizojë persona të kualifikuar për asistencë dhe
edukim,*

*të frekuentojnë institutet e burgjeve me qëllim që me veprimtarinë
e tyre të marrin pjesë në punën që synon mbështetjen morale të
të burgosurve dhe të internuarve, që në të ardhmen të mund të
rimarrin jetën sociale.*

*Asistentët vullnetarë mund të bashkëpunojnë në aktivitetet
kulturore dhe rekreative të Institutit (të burgut) nën*

udhëzimin e drejtorit, i cili do të koordinojë veprimet e tyre me ato të gjithë stafit të specializuar për këtë punë..

Asistentët Vullnetarë mund të bashkëpunojnë me qendrat e shërbimeve sociale "provë në besim"; për regjim gjysmë-lirie dhe për ndihmë të të liruarve dhe familjeve të tyre.

**PROTOKOLL MIRËKUPTIMI
MES DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS SË BURGJEVE,
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË JASHTME TË
EKZEKUTIMIT PENAL DHE KONFERENCËS KOMBËTARE
TË VULLNETARIZMIT NË DREJTËSI
(Pjesë)**

... duke pasur parasysh rëndësinë e kontributit gjithnjë e më të rëndësishëm të dhënë nga vullnetarizmi në fushën e ekzekutimit penal dhe nën frymën e bashkëpunimit me operatorët e administratës së burgut... palët promovojnë projekte në nivel lokal, protokolle operative e konventa që synojnë favorizimin e integrimin social të dënuarve dhe atyre në masa alternative... angazhohen për të zhvilluar bashkëpunimin mes Qendrave të Vullnetarizmit, që ndihmojnë në sportelet (Sportelli Informativi Integrati-SPIAI) tashmë ekzistuese, apo hapin të rinj promovojnë hartimin dhe zbatimin e kurseve të trajnimit të përbashkëta, mes vullnetarëve dhe operatorëve; nga ana e Provediktoratit Rajonal të Administratës së burgjeve dhe Konferencës Rajonale të Vullnetarizmit në Drejtësi.

KONFERENCA RAJONALE E VULLNETARIZMIT NË DREJTËSI TRENTINO ALTO ADIGE

Konferenca Rajonale e Vullnetarizmit në Drejtësi është krijuar në vitin 2001 si një seksion i Konferencës Kombëtare, me iniciativën e disa realiteteve të mëdha lokale si: ATAS Onlus, Apas, Kooperativa sociale "Punto d'Incontro" (Pikë Takimi), Karitas, Komunitëti i Fretërve të Klesit, Kooperativa sociale "Girasole", "Odòs" Bolzano dhe SEAC (vullnetarizmi për burgjet).

Më vonë janë bashkuar me ta edhe Shoqatat AMA - "Auto Mutuo Aiuto" dhe Avokatët e Solidaritetit të Trentos dhe Roveretos, duke konsoliduar grupin tashmë ekzistues.

Objektivat e konferencës janë:

- Dhënia e ndihmës të burgosurve që ndodhen në burgjet e rajonit të Trentino Alto-Adiges,
- Mbështetja dhe mundësisht shoqërimi i tyre, nëpërmjet programeve të veçanta për rehabilitimin social.

Konferenca Rajonale mbi Vullnetarizmin në Drejtësi të Trentino Alto -Adiges aktualisht punon me grupin e vullnetarëve brenda burgut të Trentos që ndodhet në Via Cesare Beccaria, 13 Spini di Gardolo, (Zona Industriale), brenda të cilit ka: seksionin e meshkujve dhe të femrave

Kjo strukturë e re, modernë është e pajisur me teknologjinë më të përparuar, e cila ka përmirësuar kushtet materiale të burgimit, por nuk ka zgjidhur problemet e përbashkëta të instituteve të këtij lloji, domethënë:

- Përforcimin e marrëdhënieve të stafit të burgut me të burgosurit;
- Mbipopullimin (numri i të burgosurve është më i madh se kapaciteti i godinës);
- Qarkullimi i shpeshtë i të burgosurve;
- Numri i oficerëve të policisë së burgut, i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat e Institutit.

Në brendësi të këtij realiteti kompleks ka lindur, "Sporteli për Familjarët" i drejtuar tërësisht nga vullnetarët e Konferencës Rajonale të Vullnetarizmit në Drejtësi.

Një sportel brenda burgut për tre ditë në jave për bashkëbisedime me familjarët e të burgosurve (e hënë, e mërkurë dhe e shtunë) në të cilin vullnetarët janë të angazhuar në veprimtarinë e mëposhtme:

- Mirëpritje për familjarët që vizitojnë të burgosurit;

- Mirëpritje dhe veprimtari argëtuese për fëmijët që vizitojnë prindin e burgosur në mënyrë që ta kthejnë qëndrimin e tyre në ambientin e burgut sa më pak burokratik, të jetë e mundur;

- Informim mbi dispozitat në fuqi në lidhje me takimet/pakot ushqimore /pagesat në të holla;

- Informim dhe adresim në rrjetin e shërbimeve të zonës për raste nevojë e domosdoshmërie.

Grupi i vullnetarëve është formuar nëpërmjet vizitash o turneu të shoqëruara brenda institucionit të burgut dhe nëpërmjet seminareve të organizuara nga administrata e burgjeve ose shoqatat e shërbimit social të Trentinos, përfshirë në aktivitetet edukative brenda burgut dhe në ri-integrimin sociale të të burgosurve pas përfundimit të dënimit.

KUJT I DREJTOHET VADEMEKUMI

Ky udhëzues i shkurtër është projektuar dhe porositur nga Konferenca Rajonale e Vullnetarizmit në Drejtësisë (KRVD: italisht-CRVG) të Trentinos Alto-Adige, si një mjet i dobishëm për të gjithë: për të burgosurit, familjet e tyre, shërbimin social, famullitë, vullnetarët dhe vullnetaret; gjithë njerëzit të cilët, në jetën e tyre, bien në kontakt me botën e institutit ndëshkues.

Çdo ditë shërbimet që bëjnë pjesë në KRVD (italisht CRVG) takohen me njerëz që kanë nevojë për informacione të dobishme mbi shumë aspekte të shërbimeve, të dënimit dhe pas lirit. Shërbimet tona ofrojnë mirëpritje, konsulta, sistemim në punës. Megjithatë, në jemi të ndërgjegjshëm që me gjithë punën e madhe të përditshme për të rritur ndërgjegjësimin e punës sonë, jemi të njohur vetëm nga ekspertë dhe jo nga shumica e qytetarëve.

Ky udhëzues, ka për qëllim të përmbush boshllëkun e informacionit. Synimi ynë është të ofrojmë një "*hartë territoriale*" të të gjitha shërbimeve që kanë të bëjnë me të burgosurit dhe ish-të burgosurit, në mënyrë që çdo qytetar që ka nevojë, kur është i lirë ose me liri të kufizuar, mund të gjej lehtësisht shërbime sa më të dobishme.

Një nga vështirësitë që dalin më me frekuencë, si në bisedimet me familjet ashtu ehe në shërbimet për të burgosurit, është mungesa e informacionit mbi çështje me të cilat përplasen kur kanë të bëjnë me gjykimin penal.

Për këto arsye kemi ndarë tekstin në seksione; për ta bërë atë sa më thjeshtë e të kapshëm, për të gjetur informacione të ndryshme.

Në pjesën e parë kemi inkuadruar "botën" e burgut, në mënyrë që t'ju jepnim të gjithë njerëzve, një bazë të mjaftueshme mbi kontekstin në të cilin punojmë.

Pjesa e dytë është menduar për njerëzit që dëshirojnë të angazhohen në "botën" e instituteve ndëshkuese si vullnetarë, veçanërisht si figurë e asistentit vullnetar në burgje.

Në pjesën e tretë kemi thëlluar me detaje fazat e hetimit dhe të dënimit, të gjithë procesin dhe figurat profesionale të përfshira

në faza të ndryshme të procedurës penale dhe zbatimit të dënimit.

Pjesa e katërt përmban rezultatin e monitorimit të kryer në këtë zonë, është një listë e ndarë në dy provinca; institucionet e të cilave ofrojnë shërbime të ndryshme për të burgosurit - ish të burgosurit dhe Familjarët.

PSE VULLNETARIZËM

Arsyet që e shtyjnë njeriun të angazhohet në punë vullnetare janë të shumëfishta, nga motive etike - fetare deri tek angazhimi ateist ndaj njëri-tjetrit. Por pse në angazhohemi në punë vullnetare? Nuk është qëllimi ynë për të trajtuar këtë çështje në një mënyrë gjithëpërfshirëse, sepse shpjegimi do të kalonte përtej kontekstit të këtij udhëzuesi.

Shumë prej nesh janë ose kanë qenë vullnetarë, prandaj do të donim të shihnim arsyet pse e marrim këtë angazhim.

Kur në mendojmë angazhimin tonë si vullnetarë; mendojnë qindra njerëz që kemi takua në rrugën e përshkuar; mendojmë, jo çfarë kemi "bërë" në për ata, por sa në jemi pasuruar nga ata gjatë gjithë takimeve. Ndoshta një motivim kyç që nuk shprehet qartë është që: duke bërë punë vullnetare për të tjerët bëjmë edhe për vetën tonë; për përmbushjen e jetës sonë; për pasurimin e saj me diçka të vlefshme me të cilën realizohemi dhe që e marrim si dhuratë nga të tjerët. Pastaj diferenca e motivimeve bie, sepse kuptimi dhe motivi i vullnetarizmit nuk është më i dhënë nga në, por nga të tjerët të cilët vetëm për faktin që hynë në marrëdhënie me në, na pasurojnë ashtu si edhe komunikimi me në pasuron ata. Ja që pasurim (dhuratë) e arritje në jetë shkojnë dora në dorës.

I njëjti Legjislacioni ka perceptuar në Ligjin Kuadër (Kornizë) mbi vullnetarizmin (L. 266/91) jo vetëm rëndësinë e vullnetarizmit, por mbi të gjitha rëndësinë e raporteve (marrëdhënieve) të organizatave të vullnetarizmit: jo si një person i vetëm, por si një organizatë shoqërore.

Të jesh vullnetar nuk është një angazhim personal në favor të një personi tjetër por një përpjekje e komunitetit që përballon vështirësitë duke kërkuar të zgjidhë problemet, të gjithë së bashku.

PSE VULLNËTARIZËM NË BURGJE

Vullnetarizmi në burgje ka një histori të gjatë. Kur flasim për vullnetarizmin në burgje nënkuptojmë vullnetarizmin brenda dhe jashtë mureve, megjithëse shoqatat tona veprojnë kryesisht jashtë burgut për të ofruar hapësirë për ri-integrimin social dhe profesionale për të burgosurit apo ish-të burgosurit.

Por kush është angazhimit brenda mureve në favore të të burgosurve? Cili është funksioni, që ligji parashikon, për vullnetarin?

Prania e vullnetarëve në burg është parashikuar nga nenet. 17 e 78 të *Rregullores së Burgjeve (Ordinamento Penitenziario)* (Ligji 354/75) dhe e specifikuar nga nënët. 68 e 120 të Dekretit Presidencial 320/2000, cd. "*Rregullorja mbi klasifikimin e burgjeve.*"

Këto nënë rregullojnë pjesëmarrjen e asistentëve vullnetarë; në aktivitetet që kanë si qëllim "rehabilitimi social të të dënuarve dhe internuarve; vullnetarizmi në mbështetje morale të të burgosurve dhe të internuarve si dhe ri-integrimin ardhshëm në jetën shoqërore" (neni 78).

Kështu Vullnetari kalon nga një rol i ngushtë i asistentit në një rol më aktiv: atij i njihet roli si bashkëpunëtor për ri-integrimin social, i parashikuar nga nen. 27 i Kushtetutës, një rol që nuk është një zëvendësim dhe as thjeshtë mbështetje për zgjidhjen e gjërave që nuk shkojnë në sistemin e burgjeve. Kështu vullnetarizmi në burgje vepron në një optikë i një konteksti më të gjerë dhe të finalizuar që përfshihet në linjën e Ligjit Kornizë.(Kuadër) 266 e '91, i cili njihet rolin e vullnetarizmit të organizuar, si një rol aktiv në pjesëmarrjen dhe stimulimin ndaj institucioneve dhe organizatave të sektorit publik, me një fjalë i njëjti rol politik.

Duke konsideruar potencialin e vullnetarizmit në burgje brenda një kuadri më të gjerë, atij të vullnetarizmit në përgjithësi duhet

praktikisht të përcaktohen detyrat dhe funksionet që kryen duke vepruar brenda burgut dhe si duhen kryer ato.

Në përmbledhje, mund të themi se vullnetari kryen këto detyra:

- krijimin e marrëdhënieve me të burgosurit që synojnë jo vetëm për të siguruar mbështetje (edhe) morale të menjëhershme, por gjithashtu të ndihmojë ish- të burgosurin në ri-integrimin shoqëror, gjë që ka humbur kur ka kryer krimin dhe është dënuar;

- të veprojë si një urë mes brenda dhe jashtë burg, duke thyer kështu ndarjen që karakterizon jetën brenda burgut me atë jashtë tij; në mënyrë që të përgatisë ri-integrimin e të burgosurve pas mbarimit të dënimit.

Për ta bërë këtë, vullnetari, për ligj, duhet të bashkëpunojë me figura të ndryshme profesionale që punojnë në institutet e burgjeve nën kontrollin e drejtorit: por duhet që ai gjithmonë të ruajë autonominë e vet në bashkëpunim me punonjësit e burgut, duke respektuar rregullat, rolin dhe njerëzit me të cilët punon në burg. Marrëdhënia në mes të burgosurve dhe vullnetarit e merr forcën më të madhe të saj nga kjo autonomi; është kjo paanshmëri që i lejon atij të shohë dhe gjykojë se çfarë është e gabuar dhe të bëjë propozime dhe sugjerime për mbrojtjen e të vobektëve.

Për të kryer aktivitetet e tij, është shumë e rëndësishme që vullnetari, përveç motivi të fortë, duhet të zotërojë një formim shkollor të përshtatshëm, që do t'i lejojë të përballojë situata veçanërisht të vështira nga këndvështrimi i relacionit (me të burgosurit dhe personelin e burgut), një njohuri të mirë të koncepteve bazë që lidhen me terminologjinë juridike, një aftësi të lartë për të vepruar në një rrjetë bashkëpunimi me subjektet e tjera: kryesisht me vullnetarë; dhe shoqatat e tjera që punojnë në burg dhe pastaj me organizatat dhe shoqatat e specializuara që veprojnë jashtë;

- nxitjen e ri-integrimit social të të burgosurve edhe duke rritur ndërgjegjësimin e opinionit publik.

Në lidhje me këtë çështje, funksionet thelbësore të vullnetarizmit në burgje janë:

- të sigurojë praninë e tij, pjesëmarrjen e komunitetit të jashtëm brenda burgjeve e "të nxjerrë jashtë" mureve të institucioneve të vetë burgjeve: nevojat, propozimet dhe reflektimet e personave me të cilët ai ndeshet çdo ditë, të cilëve u di realitetin e jetës. "Është pra e rëndësishme që vullnetarët të shmangen nga mbyllja (tkurrja) në aktivitetet e tyre dhe t'i përkushtohen edhe punës për përhapjen e informacionit dhe publicitetit. Për këtë duhet të nxitën vazhdimisht mediat. Mundësitë janë të ndryshme: nga organizimi i ngjarjeve kulturore me interes publik, në përshkrimin e situatave të veçanta të disa Instituteve Ndëshkues (burgjeve).

Në çdo rast, qëllimi është, të krijohen mundësi për diskutim dhe për të lehtësuar njohjen dhe krahasimin në mes Institucionëve Ndëshkues (burgjeve). dhe shoqërisë jashtë tyre.

Në shpresojmë që vademekumi që prezantuar të jetë një ndihmë e vlefshme për të kuptuar "*planetin burg*", duke siguruar një përshkrim, sa më të thjeshtë të jetë e mundur, në kompleksitetit të tij, dhe njëkohësisht të vlejë dhe të ndihmojë për të qenë sa pranë të burgosurve gjatë periudhës së vështirë të dënimit të tyre.

PJESA E I. "PLANETI BURG"

1. Korniza Normative

Dy tekste kryesore të legjislacionit rregullojnë drejtësinë e ndëshkimit (burgut):

- Ligji që rregullon burgjet quhet, "**Ordinamento Penitënziario**" (L. 354/1975, që tani e tutje shënohet: OP). Është ligji i Reformës së Qendrave Ndëshkimore (Burgjeve), që ka hyrë për të zëvendësuar Rregulloren paraardhëse të vitit 1931. Fut parimin e riedukimit të të pandehurit, në pajtim me nën. 27 të Kushtetutës, dhe të disiplinës, ndër të tjera, edhe alternativativa ndaj burgimit (nën. 47 ff), lejet e veçanta, nën. 30 (b), të punës jashtë (nën. 21);

- relativisht, "**Regolamento di Esecuzione**" (Rregullorja e ekzekutimit) (D.P.R. 320/2000, tani e tutje shënohet R.E.).

Ka hyrë në shtator të vitit 2000, ai parashikon edhe ndryshime të ndryshme strukturore dhe organizative në **Institetet e dënimit**.

Këto dy tekste paraqesin mjetet bazë për njohjen organike të sistemit aktual, të burgjeve i cili vazhdimisht kujton të gjitha ndryshimet e mëvonshme dhe shtesat: ajo është, pra, e rëndësishme që të njihen mirë.

Le të përmendim shkurtimisht disa ligje paralele ose modifikime të legjislacionit të mësipërm, të cilit, do ti referohen shpesh, në faqet e mëposhtme:

- **Ligji Gozzini (L. 663/86)**

Ligji që ka zgjeruar përfitimet dhe masat alternative të ofruara nga OP. Në '91-'92, u prezantuan kufizime të ndryshme për dhënien e përfitimeve, si veprim për të luftuar krimin e organizuar, i cili faktikisht, çoi në kufizime të rëndësishëm të përfitimeve, për një pjesë të të dënuarve.

- **Ligji Simeoni – Saraceni (L. 165/98)**

I aprovuar në 1998, lejon që të dënuarit që kanë për të kryer një dënim me burg, ose një pjesë të mbetur prej më pak se gjashtë vjetësh, mund të kalohen nga burgu në një dënim alternativ.

- **Ligji Smuraglia (L. 193/2000)**

Në fuqi që nga viti 2000. Ofron lehtësim taksash për ndërmarrjet që punësojnë me të burgosur (si brenda Institutit të Dënimit, ashtu edhe me ata që janë lejuar të punojnë jashtë) gjithashtu edhe me ish-të burgosur (në gjashtë muajt e parë pas përfundimit të dënimit).

- D.P.R. 309/1990

Është tekst unik mbi normativat për narkomanët dhe të alkoolizuarit. Përveç që rregullon të gjitha krimet në këtë fushë, i beson administratës së burgut detyrat e reja të parandalimit dhe trajtimit të infeksionit nga HIV në burgje: trajtim socio-mjekësor, rehabilitim dhe ri-intëgrim social të të burgosurve narkomanë dhe alkoolistë. Gjithashtu parashikon në nën. 94, në cd. provën në besim, në rastë të veçanta.

- Normativa mbi imigracionin

D.Lgs 286/1998 (Ligji Napolitano Turko) reformoi të ashtuquajturin "ligj Martëlli" i mbetur në fuqi që nga '91 në '98, i cili është ndryshuar ose plotësuar disa herë: së fundi nga Ligji Nr 184/2002 "Ligji Bossi-Fini", ky i fundit, ndër të tjera, prezantoi dëbimin nga Italia si një alternativë ndaj burgimit për të dënuarit me më pak se 2 vjet burgim ose arrestim.

- Ligji ex Cirielli (L. 251 /2005)

Fut ndryshime në Kodin Penal dhe OP, duke shkurtuar kohën e "prescrizione" dhe duke rritur dënimet për shkelësit përsëritës (recidiv).

- Ligji Alfano (cd. svuotacarceri) (L. 199/2012)

Masa parashikon ngritjen e dënimit nga dymbëdhjetë në tetëmbëdhjetë muaj burgim, që mund të jetë edhe arrest shtëpije pra duke aplikuar "burgimin" në banesën e të dënuarit dhe jo në burg, i parashikuar edhe në L. 199/2010

2. Institutët e ndërkshimit

Institutët në të cilët kalojnë të ndëshkuarit me një masë që përfshin privimin e lirisë janë të ndarë, në varësi të llojit të masës aplikuar për pozitën juridike të të burgosurve (arrestuar apo dënuar) dhe kohëzgjatjen e dënimit në:

A. Istitutet ku vuajnë dënimet e tyre

- "Case circondariali" (Shtëpi të rrethuara-burgje)

Në këtë qendra mund të mbahen të pandehur që janë në dispozicion të cilitdo autoritet gjyqësor, si dhe të dënuar me arrestim ose me burgim deri në një maksimum prej 5 vjetësh, duke përfshirë edhe ata të cilëve u kanë mbetur vetëm 5 vjet për të përfunduar dënimin.

- "Case di reclusionë" (shtëpi të veçuara-burgjet e rënda)

Në këtë qendra mund të mbahen vetëm të pandehur me burgim të përjetshëm ose me burgim për një periudhë më shumë se 5 vjet.

B. Istitutët për zbatimin e masave të sigurisë (Masat që aplikohen vetëm për personat shoqërisht të rrezikshëm):

- "case di cura e di custodia" (shtëpi kurimi e kujdestarie);

- ospedale psichiatrici giudiziari (Spitale Psikiatrike Gjyqësore);

- colonie agricole e case di lavoro (Koloni agrikulture e shtëpi punë).

Aktualisht në **Trentino** është prezent burgu "Casa Circondariale" me zonë për meshkuj dhe zonë për femra:

- Adresa: Trento Via Cesare Beccaria,13- Loc. Spini di Gardolo,38014 TN

Tël: 0461/969101 Fax: 0461/969191


Aktualisht në **Alto Adige** është është present burgu "Casa Circondariale" vetëm për meshkuj

- Adresa: Bolzano Via Dantë,28 a - 39100 BZ

Tël: 0471/976729 Fax: 0471/982362

3. Struktura e burgut

P.R.A.P. PROVVEDITORATO REGIONALE AMMINISTRAZIONE PENITENZIARIA (PROVEDIKTORATI RAJONAL ADMINISTRATA E BURGUT)



4.UEPE (Uffici di Esecuzione Penale Esterna) (Zyrat e Jashtme të ekzekutimit Penal)

UEPE (ex CSSA) kryejnë funksion ndërlidhës mes brenda dhe jashtë burgut, me qëllimin preciz, të shoqërojnë dhe lehtësojnë të dënuarit në ri-integrimin në jetën e lirë. Koordinohen nga P.R.A.P. (Provediktorati Rajonal i Administratës së Burgut).

Brenda në burg, me kërkesë të Drejtorit të Institutit, asistentët socialë të UEPE punojnë si këshilltarë për të arritur rezultate pozitive duke lehtësuar trajtimin në burgje; jashtë burgut duke kryer detyrën e mbikëqyrësve dhe kujdesen e japin mbështetje personave të dënuar me masa alternative si paraburgim ose liri nën vëzhgim (mbikëqyrje).

Në zbatimin e detyrës së vëzhgimit dhe mbështetjes sociale në ambientin e jashtëm, UEPE bashkëpunon me institucionet dhe shërbimet sociale që ndodhen në zonë, si dhe me organizatat vullnetare e me privatët.

Gli UEPE (ex CSSA) ndjekin institucionalisht ekzekutimin e dënimeve që kryhen ose mund të kryhen në mjedis të lirë, kështu i referohemi asaj zonë e cila në vitet e fundit është quajtur "Zona e jashtme Penale".

Funksioni i tyre i parë është që të lidhen në relacion me autoritetin kompetent të Gjykatës Mbikëqyrëse, sipas nevojave e kërkesave që kanë personat, që në të ardhmen, do të ndëshkohen me masa alternative dhe jo me burgim.

Kur ky aktivitet i veçantë vëzhgimi kryhet në një mjedis të lirë para fillimit të dënimit, quhet vëzhgim nga jashtë; në qoftë se vëzhgimi kryhet në burg, kur personi është gjatë kryerjes së dënimit: quhet vëzhgim i brendshëm ose brenda-muror.

Funksioni i dytë është që të monitorojë zbatimin e duhur të masave alternative, nga më e lehta: ajo e provës në besim deri tek më e rënda: ajo me arrest shtëpiak; duke mbajtur vazhdimisht lidhje me Gjykatën e Mbikëqyrjes dhe duke i shkruar asaj vazhdimisht relacione mbi progresin e të dënuarit me masë alternative. Në zbatimin e detyrës së vëzhgimit dhe mbështetjes sociale në ambientin e jashtëm, UEPE bashkëpunon me institucionet dhe shërbimet sociale që ndodhen në zonë, si dhe me organizatat vullnetare e me privatët.

5. Personeli i Qendrës Ndëshkimore (burgut)

Asistenti vullnetar që jep ndihmë materiale dhe mbështetje morale për të burgosurit duhet të ndërveprojnë me

profesionistë të ndryshëm që punojnë në burg. Japim një profil të shkurtër për secilin.

- Drejtori

Ai ka përgjegjësinë për menaxhimin dhe performancën e Institutit në aspektin e organizimit, kontabilitetit, edukimit dhe të sigurisë. Kryeson organet kolegjiale (ekipin, bordin disiplinor, komisionin për rregulloren e brendshme dhe bibliotekën) dhe mund të autorizojë të burgosurit të punojnë jashtë (nën. 21 OP).

- Punonjësit e policisë së burgut

Të artikuluar në role të ndryshme si Agjent, Asistent, Supërintendent, Inspektor dhe Komisar, mbajnë rendin dhe sigurinë në Institutet ndëshkimore dhe marrin pjesë në aktivitetet e vëzhgimit dhe trajtimit rehabilitative të të burgosurve.

- G.O.T. dhe ekipi i vëzhgimit dhe trajtimit

Ekipi i vëzhgimit dhe trajtimit është organ kolegjial - përbëhet nga: Drejtori, Edukatori, Asistenti social, Psikologu, Mjeku, operatori i PP (Policia e burgut)- që angazhohen në observimin e personalitetit të të burgosurit dhe në hartimin e të parit dokument të të dhënave të përgjithshme mbi subjektin (raporti përmbledhës) dhe pastaj bëjnë një projekt për mundësinë e re-integrimit social të të burgosurit (plani individual i trajtimit) për të zhvilluar një trajtim rehabilitues të individualizuar.

G.O.T. (*Gruppo di Osservazione e Trattamento - Grupi i Vëzhgimit dhe të Trajtimit*) është një tip para-ekipi; është një organ më i gjerë vëzhgimi kolegjial mbi të burgosurit që në krahasim Ekipin, jep lajme e vlerësime paraprake mbi personin për tu përdorur nga operatorët e tjerë, si ato të Ser.D (Qendra për narkomanët) edukatorët, vullnetarë; t, ndërmjetësit kulturorë.

- Edukatori

Përgatit, organizon dhe koordinon aktivitetet e brendshme që lidhen me: punën, edukimin, trajnimin profesional, aktivitetet kulturore, rekreative dhe sportive; në bashkëpunim

me operatorët e tjerë. Merr pjesë në ekipin e vëzhgimit dhe trajtimit.

- Psikologu

Aktivitetet e tij përfshijnë vëzhgimin dhe trajtimin specifik për vlerësimin e personalitetit dhe elasticitetin e të burgosurve; është pjesëmarrës në takimet e ekipit. Kryen gjithashtu, ndërhyrje në mbështetjen psikologjike.

- Asistenti social

Bën pjesë në UEPE (Zyra e Jashtme e Ekzekutimit Penal). Brenda Institucionëve të burgut, kryen aktivitetin e vet i përfshirë në ekipin e vëzhgimit dhe trajtimit.

- Mjeku

Kryen vizitën mjekësore në hyrje dhe, i ndihmuar nga personeli infermieristik, ofron asistencën shëndetësore; mund të kërkojë edhe vizita të specialistëve dhe të bëjë receta për analiza jashtë burgut. Kujdesi shëndetësor në burgje: kompetenca historike e administratës së burgjeve, kohët e fundit i ka kaluar ASL (*Azienda Sanitari Locale*)-"Ndërmarrja Shëndetësore-Lokale".

- Ser.D. dhe alkolicizëm (në Alto Adige HANDS)

Shërbimi për Dipendencat (vartësitë nga drogat-narkomanët) dhe Shërbimi për Alkoolizmin (HANDS) kryejnë aktivitete për kurimin dhe rehabilitimin e të burgosurve të droguar (narkomanë) dhe të alkoolizuar. Përdorin secilën nga figurat e lartpërmendura për të kryer kompetencën e vet: mjekun (për zbulimin dhe trajtimin e sëmundjeve të veçanta dhe administrimin e metadonit) psikologun (i cili, në këtë rast, nuk është punonjës i Administratës së Burgjeve por i caktuar nga shërbimi specialistik i territorit), Asistentët socialë dhe edukatorët (gjithashtu nuk janë specialistë të administratës së Burgjeve por të caktuar nga shërbimi specialistik territorial).

- Prifti i burgut (Kapelani) dhe shërbyesit e tjerë të kultit

Garantojnë asistencën fetare dhe kryejnë një funksion të rëndësishëm në mbështetjen morale.

- Mësimdhënësit dhe punonjësit e tjerë të formimit profesional

Mësuesit e kurseve të ndryshme shkollore dhe pedagogët ose tutorët e kurseve të ndryshme profesionale favorizojnë stimulimin e vlerave të dobishme që kërkohen për rehabilitimin social.

- Gjyqtari i Mbikëqyrjes

Është Gjyqtari që kontrollon korrektësinë e kryerjes së aktiviteteve brenda burgjeve dhe të ashtuquajturës "zonë penale jashtë." Ai ka kompetencat për dhënien e lejes për nëvoja të ndryshme (nën. 30 OP), të lejes për shpërblim (nën. 30b OP) dhe lirim të parakohshëm (nën. 54 O.P.).

- Gjykata e mbikëqyrjes

Përbëhet nga dy gjyqtarë profesionistë dhe dy ekspertë laik (Asistentë socialë, psikologë, etj) Vendosë nëse të japë ose të anulojë masat alternative të ndëshkimit, rehabilitimit dhe riedukimit ose faljen e borxhit ndaj shtetit për nënshttrimin ndaj gjykimit penal (shpenzimet gjyqësore dhe të mbajtjes në burg).

6. Përsonat me privim lirie

Popullsia e "kufizuar" ndahet, në leksikun e burgut në "kategori", duke iu referuar pozitës së tyre ligjore. Është e rëndësishme të mbahet parasysh ky dallim, për shkak se disa procedura (mundësia për të bërë telefonata ose për të pranuar vizitues) ndryshojnë sipas kategorisë përfshirëse. Kështu, personat që i nënshtrohen privimit të lirisë janë të kategorizuar në:

- të intërnuarit (intërnati): janë subjekte që i nënshtrohen masës së sigurisë (me dënim) në Spitalin Psikiatrik të Drejtësisë, etj.

- të burgosurit (detenuti) janë të ndarë në:

- të hetuarit (indagati): subjekte në paraburgim, para se PM (Prokurori) të ketë ngritur akuzën në gjykatë.

- të akuzuarit (imputati): Subjekte në paraburgim sipas kërkesës së aktakuzës; para gjykimit të shkallës së parë;

- apeluesit (appellanti): subjekte ndaj të cilëve

dënimi është dhënë në shkallën e parë dhe janë në pritje të gjyqit të shkallës së dytë-apelit (nëse kanë bërë kërkesë);

- rekurs (ricorrenti): subjekte ndaj të cilëve është lëshuar dënimi i shkallës së dytë (apelit) dhe janë në pritje të vendimit të Gjykatës së Lartë (nëse kanë bërë kërkesë);

- të dënuarit ose përfundimtaret (condannati, o definitivi): subjektë ndaj të cilëve dënimi ka marrë formë të prerë, teknikisht "janë në shlyerjen e dënimit", pra, sipas ligjit, "fajtor" dhe praktikisht të destinuar në programe

PJESA E II. ASISTENTI VULLNETAR I BURGUT

1. Roli i shërbimit vullnetar në burgje

Hyrja e vullnetarëve në brendësi të Institutit të Burgjeve është i disiplinuar nga nënët 17 e 78 të O.P. (Rregullores së Burgjeve-R.B.).

Neni 17: Pjesëmarrja e komunitetit të jashtëm në veprimtarinë e riedukimit.

Ky nen-i integruar nga nen. 68 i R.E. (Rregullores Ekzekutuese)-promovon "pjesëmarrjen e privatëve dhe institucioneve, shoqatave publike ose privatë në veprimin rehabilitues" me qëllimin e "ri-integrimit social të të dënuarve ose të internuarve". Ai i njuh komunitetit të jashtëm një rol pozitiv për rehabilitimin social dhe mbështet rëndësinë e një shkëmbimi dhe kontakti të vazhdueshëm ndërmjet komunitetit të burgut dhe shoqërisë së lirë.

Puna e vullnetarëve, ish neni 17 O.P.(R.B) konkretizohet kryesisht në organizimin e aktiviteteve në grup me qëllime rekreative, kulturave dhe arsimore. Bëhet fjalë, për pjesën më të madhe, për aktivitete të veçanta gjallëruese siç mund të jenë përgatitja e një koncerti, zhvillimi i një takimi sportiv, oferta e një mbështetjeje shkollore (edukative) krahas mësimdhënies zyrtare, menaxhimi i një biblioteke. Ndër vite, nenit 17 i janë rikthyer figura të ndryshme të "sportelit" (shërbime të strukturuar informacionesh dhe konsultimi për orientimin në gjetjen e punës apo për çështjet ligjore dhe të migrimit).

Qëllimi themelor i çfarëdo aktiviteti në grup është inkurajimi i shoqërizimit midis personave që e gjejnë vetën në një situatë të bashkëjetesës së detyruar. Rezultatet janë gjithashtu edhe tek përkrahja në ndërtimin e një vizioni të përbashkët angazhimi dhe punë, në çështjet që i përkasin të gjithë personave të burgosur.

Bëhet fjalë, pra, për aktivitete që kërkojnë kompetenca dhe organizim e që janë brenda mundësive të grupeve vullnetare, që kanë një numër jo të vogël vullnetarësh;sh në gjendje të

përballojnë aktivitete, kështu të strukturuar.

Është e qartë se organizimi i iniciativave gjallëruese nuk mund të ndahet nga krijimi i një marrëdhënieje të mirë me edukatorët, që janë të autorizuar të ushtrojnë mbikëqyrje mbi këto nisma, si dhe me personelin e policisë së burgut, të cilët kanë për detyrë të kryejnë mbikëqyrjen maksimale, gjatë gjithë aktiviteteve në grup dhe angazhimeve organizative.

Pranimi i të dënuarve në këtë lloj shërbimi është përgjegjësi e Gjyqtarit Mbikëqyrës; kërkesa, e shoqëruar menjë prezantim të projekteve me të cilën pretendohet të punohet dhe të iniciativave që dëshirohet të promovohen; i drejtohet, sidoqoftë, Drejtorit të Institutit të Burgjeve, i cili kur ja përcjell Gjykatësit shpreh një opinion mbi dobitë dhe mundësitë. Gjithë aktiviteti është subjekt mbikëqyrjeje nga Drejtori i Institutit.

Neni 78: Asistenti vullnetarë;

Në bazën të këtij neni—i integruar nga nën. 120 R.E.—Asistentët vullnetarë;t marrin pjesë në punën që synon mbështetjen morale të të burgosurve, re-integrimin e mëpasshëm të tyre në jetën sociale dhe bashkëpunojnë në aktivitetet kulturore dhe rekreative të Institutit. Jemi, pra,në prani të një vullnetarizmi të qëndrueshëm, që nuk kufizohet vetëm me një aktivitet sportiv ose lojëra, por që vazhdon me kalimin e kohës përmes shoqërimit të të burgosurve gjatë gjithë historisë së tyre personale.

Përveç institucioneve penale, Asistenti vullnetar mund të bashkëpunojë, pas një trajnimi, me Sp.In.(Sportelet Informative) të U.E.P.E. (Zyrat e Jashtme e Ekzekutimit Penal-Z.J.E.P) për masa alternative mbështetjeje të të burgosurve, të të liruarve dhe familjeve të tyre.

Aplikimi për pranim në këtë lloj shërbimi duhet t'i adresohet në letër të thjeshtë drejtorit të burgut ose U.E.P.E. (Z.J.E.P) e cila do t'ja transmetojë atë në P.P. (Policinë e Burgut) përgjegjëse për vendimin. Vullnetarit, ish nëni78,i lëshohet një kartë identifikimi.

PJESA III. STUDIMI LIGJOR

1. FAZA E VLERËSIMIT

Hetimet

Faza e parë e procesit gjyqësor është regjistrimi i një personi në regjistrin e të përndjekurve për krime (vepra penale) regjistrim që natyrisht nuk i komunikohet subjektit nën hetim; personi bëhet menjëherë i hetuar apo person nën hetim. Vetëm më pas, kur Prokurori i Hetimeve (PM) formulon kërkesën e aktakuzë për Gjykatësin e seancës Paraprake (GIP) personi bëhet formalisht i pandehur.

Figurat e para që takon i hetuari përgjatë procesit janë:

a) Avokati mbrojtës

Avokati mbrojtës mund të zgjidhet nga i hetuari/i pandehuri, me pëlqimin tij (avokat mbrojtës i besuar). Në mungesë të një zgjedhjeje të tillë, i hetuari/ i pandehuri do të mbështetet nga i ashtuquajtimi avokat mbrojtës i caktuar nga gjykata d.m.th nga një avokat mbrojtës i emëruar nga zyra që ka në dorë gjyqin (seancën paraprake) në atë moment. Kushtetuta ka përcaktuar parimin e ndihmës së detyrueshme penale; nuk ekziston, në fakt, mundësia për të mbrojtur vetveten. Në momentin që i dyshuari apo familja e tij emëron një avokat mbrojtës, bie mundësia e emërimit të avokatit të caktuar nga gjykata.

Çdo person mund të emërojë deri në dy avokatë mbrojtës; nëse emërimi bëhet në burg, këshillohet që në të njëjtën kohë ti dërgohet një telegram avokatit për ta informuar për emërimin.

Avokati (edhe ai i caktuari nga gjykata) duhet të paguhet, por në rastin e të ardhurave të ulëta – të përcaktuara nga parametra të veçanta ligjore (Nenet 74 ish Dekreti legjislativ 115/2002 për shpenzimet gjyqësore) – i pandehuri mund të kërkojë mbështetjen e shtetit për të marrë ngarkim shpenzimin (e ashtuquajtura ndihmë juridike), si për avokatin mbrojtës publik edhe për atë të caktuar vetë. Nëse kërkesa pranohet, nuk është i detyruar të paguajë asnjë kompensim

për avokatin, për të gjithë periudhën pas pranimit të kërkesës.

Në gjykimin penal mund ti jepet mbështetja juridike falas qytetarëve si italianë ashtu edhe të huaj, duke përfshirë edhe të miturit, ose personat pa shtetësi që jetojnë në Itali. Për të përmbushur kushtet për ndihmë juridike: shumta e të ardhurave të marra vitin e mëparshëm (të gjithë të ardhurat e tatueshme nga tatimi mbi të ardhurat e personave fizikë (IRPEF) si paga e ardhur nga punësimi/vetë punësimi ose pensioni) nuk duhet të tejkalojë 10,766.13€ (kufi që i referohet të ardhurave të vitit 2012 – e që azhurnohet çdo dy vjet). Kufiri i të ardhurave në një gjykim penal, rritet me 1,032.91 € për çdo anëtar të familjes me të cilin bashkëjetohet dhe të ardhurat e familjarit i shtohen atyre të përfituara në atë moment (kështu që nëse familja është e përbërë nga 2 persona, kufiri i dytë ardhurave të kombinuara për tu pranuar kërkesa për ndihmë juridike do të jetë $10.766,13 + 1.032,91 = 11.799,04$ €). Nuk mund të pranohet kërkesa për mbështetje nga shteti, personave që janë nën hetime, të akuzuar ose të dënuar për veprat penale mbi mos pagesën e tatimeve (evazion tatimor) dhe që mbrohen nga më shumë se një avokat. Për të dorëzuar kërkesën për pranim duhet të kontaktohet, (për çështjet penal sekretaria e gjykatës ose Gjykatësi i seancë; Drejtori i Burgut, kur personi është i ndaluar, ose Zyrtari i Policisë Gjyqësore, kur i interesuari është në burgim shtëpie ose në një vend përkujdesjeje. Ndërsa qytetarët italianë dhe të BE-së mund të certifikojnë vetë të ardhurat, qytetarët e vendeve që nuk bëjnë pjesë në BE duhet të bashkëngjisin një vërtetim të Konsullatës së vendit të prejardhjes për të qartësuar vërtetësinë e deklaratës: ata mund të mbështetën në vetë-certifikim vetëm nëse vërtetohet që është i pamundur dokumentimi i të ardhurave (nëse personi në fjalë është objekt kufizimit të lirisë personale dhe avokati mbrojtës ose një anëtar i familjes mund të nxjerrë certifikatën brenda 20 ditëve nga data e kërkesës).

Avokati mbrojtës duhet të zgjidhet midis atyre të regjistruar në një listë të veçantë të avokatëve për ndihmë juridike në shtet, dhe nga koha që aplikimi miratohet, aplikanti nuk duhet të paguajë asgjë derisa situata e të ardhurave të deklaruara në

kohën e aplikimit mbetet e njëjtë (duhet të komunikohen, në fakt, ndryshimet në të ardhura pas dorëzimit të aplikimit: deklaratat e rreme, mos kallëzimi ose mos komunikimi i rritjes së të ardhurave gjatë periudhës së mbulimit të shpenzimeve dënohet me burgim nga 1 deri në 6 vjet e 8 muaj, me një gjobë nga 309,87€ deri në 1.549,37€ përveç pagesës së të gjitha shumave të paguara nga shteti).

Nëse personi është i arrestuar ka të drejtë të komunikojë, menjëherë dhe në çdo rast, para se të bëjë deklarata në gjykatë ose polici, me avokatin e tij; sidoqoftë gjykata, në momentin e arrestimit, e në raste të jashtëzakonshme, mund të vendosë të ndalojë komunikimin, por jo për më shumë se 5 ditë.

b) Prokurori (PM)

Është Gjykatësi i emëruar për hetimin (i identifikuar nga mediat si akuzuesi publik). Drejton hetimet duke koordinuar aktivitetin e Policisë Gjyqësore (Karabinierët, Policinë, Policinë Financiare, ...). Sistemi Gjyqësor e përshkruan si "organi që promovon drejtësinë" dhe, për këtë arsye, në rrjedhën e hetimeve, duhet të kryej gjithashtu *"hetimin e fakteve dhe rrethanave në favor"* të të dyshuarit (neni 358 K.P.P.).

c) Gjyqtari i Hetimeve Paraprake (GHP)

Është gjykatësi që mbikëqyr mbarëvajtjen e duhur të hetimeve me një rol të paanshëm midis prokurorisë dhe mbrojtjes. Ndërhyn, së pari, vetëm pas kërkesës së Prokurorit për marrjen e masave parandaluese personale o reale ose për të autorizuar përgjimet ambientale, telefonike apo kompjuterike. Vendos, më pas, në bazë të kërkesave të bëra nga Prokurori ose avokati (shtytje afati, shfuqizime ose ndryshime të masave parandaluese...).

d) Gjyqtari i Seancës Paraprake (GUP)

GUP-i, palë e tretë dhe e paanshme dhe e ndryshme nga gjyqtari që kishte funksionin e Gjykatësit të Hetimeve Paraprake, kryeson seancën paraprake, gjatë së cilës duhet të

vlerësohet mundësia që Prokurorie mbështet akuzën në gjyq me aftësi. Seanca paraprake vendoset pas kërkesës për gjykim dhe mund të përfundojë ose me një Sentencë mos gjykimi ose me një Dekret për vazhdimin e gjyqimit. Është në seancën paraprake, kur akuza ka të bëjë menjë vepër që përshkruhet në ligj, që i akuzuari mund të kërkojë që të pranohet në gjykimin e shkurtuar ose zbatimin dënimit (i ashtuquajhuri pranimit i fajësisë me një dënim më të vogël).

e) Kufizimet e lirisë personale

Gjatë hetimeve paraprake, të dyshuarit mund të kufizohet liria e tij personale në dy mënyra:

1. me të ashtuquajturën masë parandaluese, që praktikohet në rastin krimin në flagrancë nga ana e Policisë Gjyqësore (i ashtuquajhuri arrestimi në flagrancë) ose përkundrazi në rast se ekziston rreziku i arratisjes të të dyshuarit me iniciativë të Policisë Gjyqësore ose me udhëzim të Prokurorit (i ashtuquajhuri ndalimi të dyshuarit të krimin), ose,

2. pas lëshimit të një urdhri, nga ana e GIP, të masës parandaluese të kërkuar nga Prokurori. Në veçanti, kufizimi me burg mund të vendoset si pasojë e:

- arrestimit në flagrancë: i dyshuari arrestohet nga policia gjyqësore pasi kapet në aktin e kryerjes së një krimi ose menjëherë pasi e ka bërë;

- ndalim i personit të dyshuar për krim: Policia Gjyqësore, me iniciativë të vetën ose pas një dekreti të Prokurorit, mund të vendosë për ndalimin e një të dyshuari për krim, kur ka prova konkretë që mbështesin me baza rrezikun e arratisjes së tij;

- urdhëresa e aplikimit të një mase parandaluese: meqë masat parandaluese e humbasin efektin në një kohë të shkurtër, periudha e burgimit duhet të legjitimohet nga një masë parandaluese që aplikohet nga GIP pas kërkesës së Prokurorit (me seancë, të mëparshme apo të mëvonshme të të hetuarit, në fazën e pyetjes për vlefshmëri ose garanci) kur ka:

1 - prova serioze të fajit kundër një subjekti, kur janë: individualisht ose kumulative;

2 - një rrezik real të arratisjes, të falsifikimit të provave apo përsëritje të krimit (nevoja parandaluese); kur nevojat parandaluese nuk mund të mbrohen ndryshe për veprat më të rënda, gjykatësi (GIP) merr masën më serioze se ajo e paraburgimit. Përndryshe, mund të aplikojë arrestin në shtëpi (nëse ka prova të dokumentuara që disponon një shtëpi të përshtatshme), detyrimin me paraqitje në Policinë Gjyqësore, ndalimin apo detyrimin për të qëndruar në shtëpi, ndalimin e daljes jashtë vendit.

Seanca e vlefshmërisë

Pas ndalimit të një të dyshuari për krim apo arrestimit në flagrancë, Policia Gjyqësore duhet të vërë menjëherë në dispozicion të Prokurorit të ndaluarin ose të arrestuarin i cili, brenda 48 orëve pas ndalimit ose arrestimit, nëse nuk mendon se i dyshuari duhet të lihet i lirë, duhet ti kërkojë GIP-it vlefshmërinë për ndalimin apo arrestimin, i cili, nga ana tjetër, duhet të caktojë seancën e vlefshmërisë brenda 48 orëve të më vonshme (d.m.th. brenda 96 orëve pas arrestimit ose ndalimit). Në atë seancë, pas përfundimit të marrjes në pyetje të të arrestuarit/ndaluarit në prani të avokatit të tij, Gjykatësi (GIP) do të vlerësojë nëse arresti ose ndalimi janë kryer në pajtim me ligjin dhe, pas kërkesës nga Prokurori, mund të vendosë për aplikimin e masës parandaluese.

Në çdo rast kontakti me policinë ose autoritetin gjyqësor (Prokurorin ose Gjykatësin) personi nën hetim mund të shfrytëzojë të drejtën për të heshtur, pa pasoja dëmtuese.

Në fund të seancës së vlefshmërisë, GIP-i mund të shpallë të vlefshëm apo të zhvlerësojë arrestimin apo ndalimin, dhe në të dyja rastet:

- mund të aplikojë një masë parandaluese, sipas kërkesave së Prokurorit dhe në bazë të vërejtjeve të mbrojtjes, nëse e mendon të nevojshme ekzistencën e masave parandaluese; sidoqoftë, nuk mund të aplikojë masa më të rrepta sesa ato që kërkohen nga Prokurori;

- nëse nuk ka nevojë për masa parandaluese, nuk do të zbatojë asnjë masë të tillë dhe do të vendosë lirimin e

menjëhershëm të të arrestuarit apo të ndaluarit;

- Gjykatësi nuk duhet të aplikojë asnjë masë parandaluese nëse ekziston mundësia reale për të mbyllur procesin me një dënim që, sipas ligjit, do të pezullohet (d.m.th. një dënim më të ulët se dy vjet për personat mbi 21 vjeç).

- Gjithashtu, nuk mund të mbahen në burg, përjashtuar rastë të veçanta për mbrojtjen e komunitetit:

- a) gruaja shtatzënë ose nëna që jeton me fëmijë nën moshën tre vjeç;
- b) personat me moshë mbi shtatëdhjetë vjeç;
- c) personat e prekur nga patologji të tilla që i krijojnë një gjendje shëndetësore të papajtueshme me qëndrimin në burg ose personat e prekur plotësisht me SIDA;
- d) babai i fëmijës me moshë nën tre vjeç, kur nëna ka vdekur ose e ka të pamundur të kujdeset.

Ndërsa kur zbatohet një masë parandaluese e vendosur paraprakisht nga GIP-i, ky i fundit duhet të marrë masat, brenda 5 ditëve nga data e ekzekutimit (d.m.th. nga kapja e të dyshuarit) me marrjen në pyetje të personit që gjendet në paraburgim.

Masat parandaluese

Të gjitha masat parandaluese, të kërkuara nga Prokurori dhe të zbatuara nga Gjykatësi ndaj personit nën hetim, kanë si qëllim të sigurojnë tre nevoja specifike:

- rrezikun e arratisjes të të hetuarit;
- rrezikun e falsifikimit të provave;
- rrezikun e përsëritjes së krimit të të njëjti lloj: kjo është nevoja parandaluese më e përdorur, në mënyrë të veçantë ndaj personave të sikletshëm me prirje për kryerjen e krimeve (narkomanëve etj ...).

Masat parandaluese janë:

- Paraburgimi: është, ndër të ashtuquajturat masa parandaluese, ajo me rreptësinë më të madhe dhe parashikon

heqjen totale të lirisë brenda një Instituti Korrektues. Në rast dënimi, koha e kaluar në paraburgim llogaritet si dënim i kryer më parë, pasi vendoset përfundimisht dënimi i mundshëm-dhe gjithashtu shërben edhe për vlerësimin e liritimit të parakohshëm.

- Arrest shtëpie: është një formë më e butë dhe parashikon kufizimin brenda një banese (jo domosdoshmërisht të vetën) ose në një vend kurimi. Nga pikëpamja ligjore, ky sistem barazohet plotësisht me paraburgimin: zbritët nga burgimi përfundimtar dhe largimi nga shtëpia ka si pasojë akuzimin për kryerjen e veprës së arratisjes. Kontrollët i janë besuar forcave të policisë. Kufizimi mund të zbutët me dhënien e lejeve për largim herë pas here ose në mënyrë të përhershme nga GIP-i për të kryer aktivitete re-integrimi ose punësimi apo për tu kujdesur për nevojat privatë(p.sh.: për të bërë pazarin).

Gjykata e rishqyrtimit

Është një organ kolegjal i përzgjedhur për të rishqyrtuar aplikimin e një urdhërese për masë parandaluese. Kërkesa për rishqyrtim mund të propozohet nga personi nën këtë masë ose nga mbrojtësi i tij brenda dhjetë ditësh nga aplikimi i masës. Në Gjykatën e Rishqyrtimit mund të apelohe, qoftë nga i dyshuari e këtë herë dhe nga Prokurori (PM) edhe të gjitha dispozitat e GIP-it që refuzojnë, ose pranojnë, instancat e mundshme për shfuqizim apo zëvendësim të masës parandaluese në atë moment.

Lirimi

Në momentin e liritimit, të dyshuarit/të pandehurit i kërkohet të tregojë vendin në të cilin dëshiron që ti dorëzohen të gjitha dokumentet që lidhen me procesin (zgjedhja e banesës). Çdo ndryshim duhet t'i komunikohet Autoritetit Gjyqësor, në mënyrë që të merren në kohë të gjitha njoftimet që do t'i mundësojnë të ndjekë zhvillimet e procesit dhe vendimit të marrë. Ai mund të zgjedhë që ky vendqëndrim të jetë studioja e avokatit mbrojtës,por në këtë rast është e nevojshme mbajtja e

marrëdhënieve të vazhdueshme me avokatin e tij, sepse pa mundësia për ta gjetur do të pengojë mbrojtjen efektive të tij dhe vënien në dije të ndonjë dënimi të mundshëm që do të bëhet i përvokueshëm pa dijeninë e të dënuarit.

2. GJYQI

Nëse në përfundim të hetimeve, Prokurori mendon se nuk ka elementë të vlefshëm për të kërkuar arkivimin, i kërkon “Gjykatësit të seancës paraprake” (GUP) një Kërkese për dërgim në gjykim ose kërkon gjykimin menjëherë në Gjykatë Nga ky moment, personi që është nën hetim, konsiderohet “i pandehur”.

Seancë paraprake

Për disa lloj krimesh (ato që dënohen me dënimin maksimal deri në 4 vjet burgim ose të tjera specifike të precizuara në Kodin e Procedurës Penale) duhet që Prokurori (PM) ti kërkojë “Gjykatësit të seancës paraprake” (GUP) një aktakuzë për dërgim në gjykim, në baze të së cilës vendoset një seancë paraprake, e cila ka si qëllim të verifikojë, në ballafaqim dhe duke dëgjuar njëkohësisht të dyja palët (Prokurorin dhe avokatin e të pandehurit), nëse akuza është e mbështetur nga prova të vlefshme nga ana e Prokurorit. Është momenti kur i pandehuri ka mundësinë për të zgjedhur ritin alternativ (dënim i pranuar ose procesi i menjëhershëm). Nëse i pandehuri nuk zgjedh asnjë prej riteve alternative, do të ketë diskutim në seancën paraprake, e cila mund të mbyllet me një vendim për mbyllje procesi ose me një Dekret për të dërguar gjykimin përpara Gjykatës penale të shkallës së parë. Nëse zgjedh një rit alternativ, kjo do të ndodhë para “Gjykatësit të seancës paraprake” (GUP) e, në rast të gjyqit të menjëhershëm, ky mund të mbyllet me një vendim pafajësie ose dënim, ndërsa në rast kërkese aplikimi të dënimit të pranuar (*patteggiamento*) me leximin e vendimit për dënim, të akorduar nga palët..

Gjyqi normal (gjyqi i shkallës së parë)

Është forma normale e zhvillimit të procesit gjyqësor. Zhvillohet para gjykatës me një gjyqtar të vetëm (monocratico-monokratik) ose disa gjyqtar (collegiale-kolegjiale) dhe fillon ose nëpërmjet seancës paraprake (Dekret për vazhdim gjykimi) ose drejtpërdrejt në përfundim të hetimeve paraprake

(kërkesë direkte për gjykim). Në rastin e dytë, i pandehuri mund të zgjedhë një prej riteve alternative në seancën e parë, pikërisht përpara Trupit Gjykses.

Gjyqi normal (gjyqi i shkallës së parë) zhvillohet në formën e ashtuquajtur “seancë publike”, gjatë të cilit provat duhet të prezantohen në ballafaqim midis palëve (p.sh. pyetja dhe kundërpjetja e dëshmitarëve si nga Prokurori (PM) ashtu dhe nga Avokati mbrojtës). Në fakt, të gjitha aktet e hetimeve dhe ato të marra gjatë periudhës së hetimit, duhet të prezantohen e përsëriten në debat publik midis palëve.

Ritet alternative

Me qëllim përshpejtimin e kohës së gjyqit, ligjvënësi ka parashikuar mundësinë, për të pandehurin ose avokatin e tij (i cili duhet të jetë i pajisur me një mandat specifik,) të aplikojë për rit alternativ (gjyq i shkurtër dhe mbyllja e gjyqit me akordim dënimi):

- Gjykimi i shkurtër

Në këtë rast, nuk ka seancë publike dhe gjyqi konsiston në një vendim të Gjykatësit Penal të shkallës së parë në bazë të akteve prezentë në dosje të Prokurorit (të cilat mund të përdoren për vendimin në gjykimin e zgjedhur). Gjykimi i shkurtër është i dy llojeve: i thjeshtë ose i kushtëzuar në bazë të provave të reja. Në rastin e parë, nëse kërkohet nga i pandehuri, Gjykatësi është i detyruar ta pranojë; në rastin e dytë, Gjykatësi mund të vendosë nëse të pranojë apo jo kërkesën duke pasur parasysh që kërkesa për shtesën e provave të mos jetë në kundërshtim me karakteristikat e këtij lloji gjyqi: ritin e gjyqit të shpejtë. Gjykatësi mund të autorizojë gjithashtu dhe Prokurorin që të kundër provojë; sidoqoftë, mund të kërkojë prova të reja. Gjykimi i menjëhershëm përkufizohet si “premiare” për faktin se në rast dënimi, të pandehurit, i cili ka kërkuar këtë lloji gjykimi, i ulet dënimi në

masën 1/3 e asaj që është vendosur Është një gjykim i plotë i cili mund të mbyllet me një vendim ose me mbyllje të procesit pa dënim. Kundër vendimit me dënim, i pandehuri mund të propozojë Apel në shkallë të dytë ose në shkallë të tretë.

- Mbyllja e gjyqit me akordim dënimi (patteggiamento)

Të dyja palët (Prokurori dhe i pandehuri) bien dakord në klasifikimin ligjor të faktit dhe llojin e dënimit që do i jepet të pandehurit dhe prezantojnë akordin përpara trupit gjykues. Pranimi i dënimit, nga ana teknike nuk nënkupton pranimin e fajit por, implikon heqje dorë nga mbrojtja në gjykim. Aspekti premial përbehet nga ulja e dënimit final deri në 1/3. Gjykatësi mund të pranojë kërkesën ose mund ta refuzojë kur mendon si jo të saktë klasifikimin ligjor të faktit ose kur konsideron dënimin jo të përshtatshëm (sidoqoftë Gjykatësi nuk mund ta ndryshojë pa nonsensin e palëve); nëse refuzon kërkesën, Gjykatësi duhet të deklarohet jo kompetent për vazhdimin e gjyqimit dhe i dorëzon aktet e çështjes një Gjykatësi tjetër. Kundër vendimit për pranim dënimi nuk mund të propozohet Apel në Gjykatën Penale të shkallës së dytë, por vetëm në Gjykatën e Lartë për arsye ligjshmërie.

Ritet speciale

- Procedura e menjëhershme

Është një procedurë speciale debitimi, jo premiale. Përfundon menjëherë para trupi gjykues i shkallës së parë, duke kapërcyer atë të seancës paraprake. Zgjedhja e procedurës së menjëhershme është kompetencë e Prokurorit dhe ka si kusht arrestimin e të pandehurit në flagrancë të krimit. Prokurori ka 48 ore kohë nga arrestimi për të prezantuar të arrestuarin përpara Gjykatësit, të cilit i kërkon aprovimin e arrestit dhe hapja e gjyqimit të menjëhershëm. Njëherë që aprovohet arrestimi, vazhdon gjykimi dhe i pandehuri (ose avokati i tij) mund:

- 1) të kërkojë një periudhë kohe për organizimin dhe strategjinë mbrojtëse;
- 2) të kërkojë përkufizimin e procesit nëpërmjet gjyqimit të

shkurtër, ose pranimin e dënimit

3) të kërkojë vazhdimin me gjykimin e shkallës së parë (normal). Nëse kjo kërkohet nga Prokurori, Gjykatësi mund të marrë një vendim për masë parandaluese.

- Gjykimi i menjëhershëm

Gjykimi i menjëhershëm është një lloj tjetër i proceseve speciale, jo premiale, që karakterizohet nga mungesa e fazës të seancës paraprake. Mund të kërkojë nga Prokurori, dhe të pranohet nga Gjykatësi kur prova duket evidente dhe i akuzuari (në gjendje të lire) të jetë marrë në pyetje mbi faktet e kontestuara ndërsa mund të kërkojë, por duhet të pranohet, kur kërkesa bëhet për një krim për të cilin i akuzuari është në masa sigurie. Edhe në këtë rast i pandehuri, brenda 15 ditëve nga dita kur është vënë në dijeni të Dekretit për gjykim të menjëhershëm, mund të kërkojë gjykimin e shkurtër, akordimin e dënimit ose të pranojë që procesi të zhvillohet në formën normale.

- Dekreti penal i dënimit

Është një procedurë e zgjedhur nga Prokurori e llojit “pa diskutim”. Ka si qëllim të evitohet çdo lloj seance dhe nuk konsideron asnjë rol aktiv të të pandehurit. Prokurori, në fakt, mendon se procedura mund të mbyllet me një dënim që shndërrohet në një gjobë me pagesë, dhe për këtë arsye i kërkon gjykatësit të dekretojë Dekretin e dënimit për pagesën e gjobës. I pandehuri ka dy alternativa: të paguaj gjobën për të cilën është dënuar ose ta kundërshtojë (brenda 15 ditësh nga dita kur ka marrë njoftimin) duke kërkuar gjykimin e menjëhershëm, gjykimin e shkurtër ose akordimin e dënimit.

Apeli në shkallën e dytë dhe Rekursi në Gjykatën e Lartë

Vendimet për dënim mund të apelojnë, brenda periudhës së parashikuar, duke paraqitur Aktin e Apelit të arsyetuar në Sekretarinë e Gjykatësit që ka dhënë vendimin, nëpërmjet zyrës së burgut. Apeli mund të prezantohet si për motive esenciale (konsiderimi i fajshëm apo i pafajshëm), ashtu si dhe thjesht për dënim të tepruar apo për mos njohje të lehtësirave

të dënimit. Me apelin, një gjykatës i një shkalle me të lartë (Gjykata e apelit) rishikon arsyet dhe motivet në bazë të të cilave Gjykatësi ka vendosur dënimin apo pafajësinë. Kur është vetëm i pandehuri që propozon apel kundër vendimit me dënim, kemi të bëjmë me cd ndalimin e “*reformatio in peius*” që do të thotë se Gjykata penale e shkallës së dytë nuk mund të japi një dënim me të lartë se atë që ka dhenë gjykata penale e shkallës së parë. Nëse apeli propozohet dhe nga Prokurori (kundrejt një vendimi pafajësie o sidoqoftë për të kërkuar një dënim me të ashpër se ai i dhënë nga shkalla e parë) kjo pengesë bie dhe Gjykata penale e shkallës së dytë mund të vendosë një dënim akoma më të ashpër se ai i vendosur nga Gjykata penale e shkallës së parë.

Rekursi në Gjykatën e Lartë (Kasacion) është një mjet nëpërmjet të cilit analizohen çështjet ligjore dhe shkeljet e ligjit në vendimet e marra nga gjykatat e mëparshme. Gjykata e Lartë me qendër në Romë, është në fakt Gjykatësi i legjitimitetit dhe nuk diskuton përmbajtjen në bazë të të cilave është vendosur dënimi apo pafajësia. Duhet të përmbahet në verifikimin nëse vendimet e marra nga Gjykatat e mëparshme, janë marrë duke respektuar principet e të drejtës apo jo. Rekursi në Gjykatën e Lartë mund të propozohet personalisht nga i pandehuri, edhe nëpërmjet zyrës së burgut, ose nga avokati nëse është licencuar (nëse ka kompetencën-liqencën) për tu paraqitur para Gjykatës të Lartë.

Recidivat dhe ligji ex Cirielli (L. 251/2005)

Ligji 251/2005, i ashtuquajhuri *ex Cirielli*, modifikoi, nga një anë disiplinën e të ashtuquajturës recidivat (përsëritësit) dhe, nga ana tjetër, disiplinën e skadimit (*prescrizione*) të krimeve, duke futur mekanizma për shtimin e skadimit (*prescrizione*) për personat recidiv.

Është recidiv (neni 99 Kodi Penal) ai person i cili pasi është dënuar për një krim të kryer pa dashje (*non colposo*), kryen një tjetër krim pa dashje (*non colposo*); në veçanti është recidiv përsëritës (*recidivo reiterato*) personi që, veç faktit që është recidiv, kryen përsëri një krim tjetër. Ligji i ri (neni 99, c.4 Kodi

Penal) godet kryesisht personin recidiv, përsëritës:

- në profilin e skadimit (prescrizione) të krimit, ligji parashikon vetëm për personin recidiv përsëritës një periudhë skadimi (prescrizione) me të gjatë;

- në aspektin dënimit me e gjoba është sanksionuar ndalimi i mbizotërimit të gjykimit e balancimit me rrethana lehtësuese të përgjithshme sipas (Nenit 62 bis c.p.-k.p.) mbi recidivizmin (përsëritjen) ex nen. 99, paragrafi 4, cpp: Kodi i Procedurës Penale. Personi recidiv, vetëm për faktin se ka kryer krim përsëri, dënohet me dënime më të ashpra, pasi nuk mundet, me përjashtim të rasteve të veçanta, të aplikojë regjimin e mbivlerësimit të lehtësirave (atenuante);

- në momentin e ekzekutimit të dënimit, personit recidiv (përsëritës) nuk mund ti lejohet pezullimi i urdhrit të ekzekutimit (për dënimet jo më shumë se 3 vjet burg), kështu që burgimi do të jetë i menjëhershëm. Në këtë mënyrë, kërkesa për lejimin e një mënyre tjetër shlyerje dënimi mund të bëhet vetëm nga burgu.

Këto norma kufizojnë fuqinë fakultative të Gjykatësit për të vlerësuar rrethanat e personit që ka kryer krimin, dhe prekin principin e përgjithshëm sipas të cilit janë disa faktorë që duhen mbajtur në konsideratë kur jepet një dënim (neni 133 c.p.-k.p.)

3. FAZA E EKZEKUTIMIT

C.D. (Dënimi përfundimtar) "ekzekutimi" është faza kur Shteti zbaton me ekzaktësi atë që është vendosur me vendimin përfundimtar, të formës së prerë (vendim që nuk mund të apelohej me në asnjë Gjykatë), nëpërmjet shlyerjes së dënimit.

Për operatorët social është e rëndësishme të kuptojnë alternativat e mundshme që mund ti ofrohen të dënuarit kundrejt shlyerjes së dënimit në burg. Faktikisht, funksioni rehabilitativ i dënimit me burg është një ide që aktualisht ka disa kufizime, jo për faktin se nuk konsiderohet i vlefshëm, sesa për faktin se realizimi i saj, në kohë, nuk ka dhënë efektet e dëshiruara nga ligjvënësi që ndryshoi sistemin e dënimit.

Ja përse "vullnetarizmi" dhe sektori i tretë, kërkojnë të japin një përgjigje sa më të përshtatshme për re-integrimin social, për të mbyllur ato boshllëqe që Ligji nuk i ka plotësuar.

Subjektet

Subjektet që i dënuari përballon gjatë këtij procesi janë:

- Prokura: organi kryesor i ekzekutimit, jep urdhrin për ekzekutimin dhe përcakton fundin e dënimit (të përkohshëm, pasi mund të ndryshojë sipas lehtësimit që mund të bëhet apo ashpërsimi nëse ka dënime të reja);

- Gjykatësi i ekzekutimit: është kompetent mbi të gjitha çështjet rreth vlefshmërisë e titullit të ekzekutimit për të cilin është dhënë dënimi; vendos mbi aplikimin e amnistisë apo disiplinën e krimit të vazhdueshëm. Gjykatësi i ekzekutimit është ai që ka dhënë dënimin në shkallën e parë, ose, në rast se dënimi është ndryshuar në Apel (jo vetëm për madhësinë e dënimit) është Gjykatësi i apelit;

- Gjykata e mbikëqyrjes: është e përbërë prej 4 personash: Presidenti, një jurist dhe dy profesionistë që i përkasin fushave si ato të psikologjisë, shërbimeve sociale, pedagogji, psikiatri dhe kriminologji klinike. Ka kompetenca për të vendosur mbi

lëshimin e masave të tjera, mbi heqjen e tyre, mbi ankesat në fushën e lejeve.

- Gjyqtari i mbikëqyrjes: është organ i përbërë nga një person i cili vëzhgon mbi organizimin e Institutit të Parandalimit dhe të Dënimit, vendos me urdhër mbi kërkesat për leje dhe për lirim paraprak, aplikon në mënyrë të përkohshme mbajtjen me arrest shtëpie dhe lëshimi në provë tek Shërbimet sociale.

Ligjet

Ligji, të cilit merret i referohemi më shpesh në fushën e ekzekutimit penal është “Ordinamento Penitenziario” (Rregullorja mbi Ndëshkimet/burgjet) pra Ligji 354/1975 (dhe modifikimet pasuese), e i plotësuar nga Rregullorja e Ekzekutimit (Dekret i Presidentit të Republikës - DPR).320/2000.

Me këtë ligj, për here të pare janë futur dhe disiplinuar, në ordinamentin italian, masat alternative ndaj burgimit, pra mundësia konkrete të shlyhet dënimin ose pjesë e tij jashtë burgut. Mund të përfitojnë të burgosurit me dënim të marrë përfundimisht: që duhet të shlyejnë dënimin ose një pjese të mbetur të tij, sipas kushteve të vëna nga ligji, dhe që kanë treguar progres në procesin e rehabilitimit social.

Me rëndësi të veçantë është përmbajtja e nenit 4-bis të “Ordinamento Penitenziario”: i quajtur "neni simbol"; i rishkruar e modifikuar disa here nder vite, përmban listën e disa krimeve cd (të ashtuquajturat penguese) që parashikojnë përjashtimin ose përkufizimin e disa kategorive të burgosurish të cilët nuk mund të përfitojnë këto lehtësira.

Me një ndryshim të bërë Kodit të Procedurës Penale me L. Simeone-Saraceni (L. 165/98) u parashikua mundësia për të hyre në masat alternative të burgimit drejtpërdrejt nga gjendja e lirë (pa hyrë fillimisht në burg): në rast urdhri për burgim, për një dënim i cili nuk i kalon 3 vjet (6 vjet në rastin e personave narkoman) i njoftohet të dënuarit dhe njëkohësisht pezullohet për 30 ditë: në këtë periudhë i interesuari mund të kërkojë aplikimin e masave alternative. Nëse kjo periudhë kalon pa

asnjë kërkesë, Prokurori heq pezullimin dhe urdhëron arrestimin, pra futjen në burg: përndryshe, nëse në këtë periudhë 30 ditore i dënuari, i cili duhet të gjejë një zgjidhje që e lejon të evitojë burgun: paraqet kërkesën duke i bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm, Prokurori mban pezull ekzekutimin dhe transmeton dokumentet për vendim Gjykatës së Mbikëqyrjes kompetente të zonës.

Cituar nga Ligji ex Cirelli, ka sjellë një ndryshim në nenin 656 të c.p.p (k.p.p) duke vendosur se Prokurori nuk mund të pezullojë urdhrin e ekzekutimit për personat recidiv/përsëritës, të cilët përfundojnë menjëherë në burg. Kështu që, një person në gjendje të lirë, të cilit i njoftohet, mbase edhe pas disa vitesh, një vendim dënimi përfundimtar: edhe kur dënimi është më i shkurtër se 3 vjet, burgimi duhet të bëhet menjëherë, nëse subjekti është "recidiv/përsëritës" (personi mund të prezantojë kërkesë Gjykatës së Mbikëqyrjes për masa alternative, vetëm pasi të jetë burgosur).

Kur kërkesa është paraqitur nga një i dënuar në gjendje të lirë, Gjykata e Mbikëqyrjes kompetente fikson seancën për dhënien e masës alternative të kërkuar dhe koha nga paraqitja e kërkesës deri në seancën për vendim, i nevojitet Zyrës së Jashtë të Ekzekutimit Penal (UEPE-Ufficio di Esecuzione Penale Esterna), për të kryer hetime social-familjare të nevojshme për të verifikuar meritat(në çfarë janë bazuar) e kërkesës së paraqitur.

Masa alternative, leje, avantazhe të tjera

Kërkesat (të quajtura jo korrektesisht "pyetje") parashikojnë një fazë përgatitore/hetimi (përmbledhje të informacioneve) dhe një fazë vendimtare: nëse është Gjykata e Vëzhgimit që vendos, kjo fikson seancën e cila zhvillohet me dyer të mbyllura (vetëm në prezencën e të interesuarit, të Prokurorit dhe Avokatit, pra pa pjesëmarrje të publikut të jashtëm).

- Provë në besim të shërbimit social (neni. 47 O.P. e neni. 96 a 98 R.E.)

Kjo është masa alternative më e përsosur dhe leja për aplikim është kompetencë e Gjykatës së Mbikëqyrjes. Në qoftë se dënimi, ose koha e mbetur e dënimit është më pak se tre vjet, Gjykata e Mbikëqyrjes - pas përgatitjes së dokumenteve (pas kontrollit të forcave të policisë, pas intervistës me të dënuarin dhe familjen e tij, pas kontrollit nëse ka hetime në vazhdim, ...) - do t'i besojë të dënuarin shërbimit social derisa të ketë përfunduar dënimin e mbetur, atëherë kur çmon që masa kontribuon, përmes rregullave të vendosura, në rehabilitimi e të dënuarit që të ketë disponueshmëri pune, një shtëpi të përshtatshme dhe nuk ka asnjë rrezik për kryerje të krimeve të tjera. Kjo masë mund të zbatohet (aplikohet) për një numër të papërcaktuar herësh vetëm nëse nuk ka pasur asnjë revokim; ndërsa kufizime janë vendosur për shkelësit dhe përsëritësit. Pas kryerjes së dënimit, natyrisht atë të reduktuar pas zbatimit të masave lehtësuese, është parashikuar një seancë gjatë së cilës, në bazë të raportit të UEPE, vërtetohet respektimi i kërkesave: në qoftë se përgjigja është pozitive dhe shkelësi ka përputhje me rregulloren dhe ligjin edhe pas skadimit të masës alternative, dënimi është i kryer; në të kundërtën i dënuari kthehet në burg për të kryer të gjithë periudhën: edhe kohën e masës lehtësuese.

- Provë në besim në raste të veçanta për alkoolistë/toksikomanë (art. 94 D.P.R. 309/90)

Është një lloj e veçantë prove në besim të shërbimit social, me subjekte që janë në situatë varësie ndaj drogës apo alkoolit. Kërkesa duhet të shoqërohet nga një certifikatë e varësisë toksike/alkoolit të lëshuar nga shërbimi publik (ose privat i akredituar), si dhe përshkrimi i plotë i projektit të shërimit sipas akordit, Gjykata Mbikëqyrëse është kompetent për dhënien e masës lehtësuese.

Gjyqtarit Mbikëqyrës, nëse i kërkohet të mbështesë masën lehtësuese, mund të sigurojë zbatimin e një mase alternative përkohësisht: ndërsa pritet verifikim zyrtar nga ana e Gjykatës Mbikëqyrëse deri në seancën për vendim (cd dhoma e këshilli). Dallimi nga provë në besim të zakonshme, është se,

ndërsa kjo sipas nën .47 jep fushë të gjerë kompetencave të Gjykatës në vlerësimin e rezultateve të vëzhgimit të personalitetit dhe prognozës për mundësi rehabilitacione sociale - në provë në besim për toksikët dhe alkoolistët, pasi të jenë krijuar kushtet e parashikuara nga Dekreti Presidential nen. 94 D.P.R. 309/90, pranimi është pothuajse automatike. Ka kufizime për shkelësit dhe përsëritësit.

- Burgim shtëpie (art. 47 tër O. P. e art. 100 R.E.)

Kjo masë shumë shpesh ngatërrohet me arrest shtëpie (e cila është një lloj tjetër mase sigurie), është e ngjashme vetëm për disa metoda aplikimi, dhe sepse është kompetencë e Gjykatës së Mbikëqyrjes.

Ligji ish- Cirielli ka ripërcaktuar kriteret për zbatimin e saj, me vëmendje të veçantë për pozitën e shkelësve përsëritës. Mund të shlyejnë dënimin në burgim shtëpie:

- ata që kanë mbushur 70 vjeç dhe nuk janë deklaruar shkelës përsëritës apo nuk janë kriminelë të përhershëm mund të shlyejnë dënimin, *të çfarëdo kohëzgjatjeje*, me burg shtëpie (me përjashtim të disa krimeve të rënda).

- ata që kanë për të shlyer dënimin, ose dënimin e mbetur jo më shumë se dy vite, pavarësisht nga kushtet e mësipërme, kur nuk përfitojnë nga masa lehtësuese e provës në besim por përjashtohen, si përsëritësit;

- ata që kanë për të shlyer dënimin, ose dënimin e mbetur jo më shumë se katër vite (tre vite për të dënuarit përsëritës); në qoftë se është grua shtatzënë apo nënë e fëmijëve nën moshën dhjetë vjeç dhe bashkëjetues me to; në qoftë se është baba ose ushtron pushtet atëror për fëmijë të vegjël nën moshë dhjetë vjeç që bashkëjetojnë me të; kur nëna ka vdekur ose është absolutisht e paaftë të kujdeset për to; nëse personi është në kushte shumë të rënda shëndetësore, për të cilin kërkohen kontakte të vazhdueshme me shërbimin shëndetësor territorial; në qoftë se personi është nën moshën njëzet e një vjeç dhe janë vërtetuar nevoja shëndetësore, studimi, pune e familjare;

- Gjykata e Mbikëqyrjes mund të aplikojë burgimin shtëpiak

edhe për dënim me burg të çfarëdo kohëzgjatjeje kur për gjendjen shumë të rëndë të subjektit, duhet të shtyjë dënimin e detyruar apo fakultativ. Individët të cilët përfitojnë nga kjo masë janë: gratë shtatzëna, nëna me fëmijë të moshës më të vogël se një vit (e detyrueshme) ose më të vogël se tre vjet (fakultative); persona të sëmurë rëndë me-SIDA apo me mungesë imuniteti të afirmuar, që janë në papajtueshmëri me regjimin në burg; persona me aftësi të kufizuara të rënda fizike; nëse është aplikuar kërkesa për falje.

Ndryshe nga masa e provës në besim, burgimi në shtëpi mbaron me shlyerjen e dënimit të plotë (dmth. pa asnjë seancë verifikimi të mëvonshme).

- Burgim shtëpie special (l. 199/2010)

Në dhjetor 2010, ligjvënësi ka parashikuar (me kadencë 31 dhjetor 2013, përveç kohëzgjatjeve) një mundësi të re të burgimit në shtëpi, i cili mund të kërkohet kur dënimi i mbetur për tu kryer nuk i kalon 18 muajt dhe në rrethana të caktuara (krime shumë serioze ose rreziku i arratisjes ose përsëritje) aplikimi i tij duhet të adresohet tek Gjykatësi Mbikëqyrës për një vendim më të efektshëm.

- Gjysmëlibrie (art. 48 O.P. e art. 101 R.E.)

Lejon të dënuarin të kalojë një pjesë të ditës jashtë burgut për të marrë pjesë në punë, shkollë o sidoqoftë aktivitete që favorizojnë një rehabilitim të dobishëm shoqëror. Përbën kështu një masë alternative si të "pavend", pasi subjekti mban njëkohësisht dy pozita shoqërore: është privat i lirë dhe është i përfshirë në një Institut Ndëshkimi (burg). Aktivitetet për të rimarrë rolin në shoqëri nuk duhet domosdoshmërisht të konsistojnë vetëm në kryerjen e një pune diku apo të një profesioni të pavarur, por është thelbësore që për gjithë kohën pas daljes nga Instituti, sfera e sjelljes të ish-dënuarit të ketë marrë një drejtim të dobishëm në ri-adaptimin në jetën normale dhe në relacionet shoqërore (p.sh. në një aktivitet studimi, ose në vullnetarizëm; për nënën, ish -e burgosura, të arrijë të kujdeset për fëmijët e saj.

Me lejen e Gjykatës së Mbikëqyrjes. mund të përfitojnë nga liria e kufizuar:

- të gjithë të arrestuarit me çfarëdo kohëzgjatje të dënimit;
- ata të dënuar me burgim jo më shumë se gjashtë muaj;
- të dënuar që në kushtet formale mund të përfitojnë nga marrja në provë në besim, por për rastin e tyre Gjykata vendos që ta zëvendësojë me liri të kufizuar;
- ata të dënuar me burgim të cilët kanë kryer të paktën 1/2 e dënimit (2/3 për shkelësit dhe përsëritësit);
- ata të dënuar për krimet; që rregullohen në 4 bis, paragrafi 1, Pjesa II, OP, të cilët kanë kryer dy të tretat e dënimit (tri të katërtat për shkelësit dhe përsëritësit);
- të dënuarit me burgim të përjetshëm që kanë kryer të paktën 20 vjet.

- Punësim jashtë burgut (art. 21. O.P.)

Kjo nuk është një masë alternative, por një masë e natyrës administrative e marrë nga Drejtori dhe e miratuar nga Gjyqtari Mbikëqyrës; konsiston në mënyrën e ekzekutimit të dënimit, e cila lejon daljen nga Instituti për të kryer punë ose të marrë pjesë në kurset e trajnimit profesional. U lejohet:

- të dënuarve që janë dënuar përfundimisht pa asnjë kufizim të pozicionit;
- të dënuarve për një vepër penale sipas nen. 4 bis O.P.C. II, për të cilët mund të aplikohet pasi të kenë kryer të paktën një të tretën e dënimit me burg; në çdo rast jo më tepër se pesë vjet;
- të dënuarve me burgim të përjetshëm, pasi ata kenë kryer së paku dhjetë vjet burgim.

Kush ka ikur, ose kush ka pasur revokim të një mase alternative, nuk lejohet të punojë jashtë për 3 vjet (nen. 58, paragr. 1 dhe 2, O.P.).

- Lirim i parakohshëm (art. 54 O.P. e art. 103 R.E.)

Qëndron në pakësim dënimi të barabartë me 45 ditë për çdo semestër të kohës së kryer. U bëhet e mundur të dënuarve të cilët kanë mbajtur një qëndrim të rregullt gjatë

burgimit dhe ka marrë pjesë në aktivitete rehabilituese. Ajo është e mundshme edhe për ata që kanë shlyer dënimin me masa alternative, duke përfshirë edhe provë në besim, për kohën me paraburgim dhe atë me arrest shtëpie (përgjashtuar masat e tjera të sigurisë).

Lirimi i parakohshëm jepet nga Gjyqtari Mbikëqyrës.

- Lejet

Leja u jep mundësi të burgosurve të kalojnë një periudhë të shkurtër kohe të lirë. Ligji përcakton dy lloj leje: lejen për nevoja dhe lejen si shpërblim.

- Leja për nevoja (art. 30 O.P.)

Leje të shkurtra për motive të rëndësishme të natyrës personale mund t'u jepen të dënuarve (edhe pse në burgim në shtëpi ose liri të kufizuar), të pandehurit (edhe nëse nen arrest shtëpie) dhe të burgosur, pa marrë parasysh vlerësime të sjelljes, gjithashtu duke marrë parasysh kërkesat nga të afërmit e personit:

- në rast rreziku të pashmangshëm jete të një anëtarit të familjes apo partner (gjendja duhet të verifikohet nga gjyqtari nëpërmjet hetimeve, madje edhe të një natyre teknike);

- për ngjarje të jashtëzakonshme dhe shumë të rënda familjare. Lejet e tilla jepen nga Gjykatësi Mbikëqyrës për të burgosurit dhe të dënuarit; nga Gjyqtari i gjyqit të shkallës së I për të pandehurit, ndërsa pas vendimit të shkallës së parë, nga Kryetari i Gjykatës së Apelit.

Kur pas sqarimit, që ekziston rreziku i kryerjes së krimeve të tjera apo të mos kthimit në burg; leja bëhet e mundur vetëm me shoqërim nga policia.

Kjo lloj leje ka një kohëzgjatje maksimale prej pesë ditësh, përveç kohës së nevojshme për të arritur në vendin ku i burgosuri ose internuari (të mbyllurit në "manikomio") duhet të shkoi (dhe të kthehet në burg).

I burgosuri që pa një arsye të vlefshme, nuk kthehet në burg pas skadimit të lejes: dënohet në një disiplinore nëse mungesa zgjat nga 3 orë, por jo më shumë se 12. Nëse

moskthimi zgjat më shumë se 12 orë atëhere ai dënohet për arratisje (evazion), ex. 385 C.P.-Kodi Penal).

Vendimi për dhënien ose anulimi i lejes është protestueshëm, nga PM (Prokurori) dhe i interesuari, Gjykata e Mbikëqyrjes (për të dënuarit) ose në Gjykatën e Apelit (për të pandehurit).

- Leje shpërblimi

Lejet e shpërblimit janë futur në rregulloren tonë nga Ligji 663/86 (i ashtuquajtur i Gozzini), sipas përvojave të ngjashme në vendet e tjera. Aplikohet vetëm për të burgosurit e dënuar përfundimisht (me përjashtim të të pandehurve dhe të intërnuarve për të cilët parashikohet leje për nëvoja):

- për të arrestuar dhe dënuar jo më se tre vjet, me gjithë kohën e arrestimit, ndërsa kur bëhet fjalë për përsëritësit (ish Cirielli) parashikohet vetëm pasi të kryejnë një të tretën e dënimit;

- të arrestuarit dhe të dënuarit për më se tre vjet, përfitojnë pasi të shlyejnë 1/4 e dënimit; ndërsa kur bëhet fjalë për përsëritësit (ish Cirielli) parashikohet vetëm pasi të kryejnë gjysmën e dënimit;

- Ndërsa të dënuarit për vepra penale të përmendura në nen. 4a O.P.C. pjesa e II, pasi të kenë kryer të paktën gjysmën e dënimit, sidoqoftë, më shumë se dhjetë vjet, nëse autorët janë përsëritës (ish Cirielli) leja aplikohet vetëm pas dy të tretave të dënimit;

- për të dënuarit me burgim të përjetshëm, pasi të kenë kryer së paku dhjetë vjet. Kompetent për dhënien e lejes është gjithmonë Gjyqtari Mbikëqyrës, i cili duhet të qartësojë përmbushjen e tre kërkesave:

- se i dënuari ka mbajtur një qëndrim të rregullt në burg (p.sh. gjatë dënimit ka shprehur ndjenjën e vazhdueshme të përgjegjësisë dhe ndershmërisë në sjelljen e tij personale, në aktivitetet e organizuara në Institut, në punë dhe aktivitete kulturore). I rëndësishëm, por jo vendimtar është mendim i Drejtorit të Burgut, që jepet pas punës së grupit të mbikëqyrjes dhe trajtimit;

- se shkelësi nuk rezulton shoqërisht i rrezikshëm. Për të

sqaruar këtë qëndrim, gjyqtari mund të marrin certifikatën penale të të interesuarit, një kopje të vendimit dhe, më e rëndësishmja, informacion nga policia e vendbanimit të tij. Informacioni thelbësor që duhet shikuar ka të bëjë me gjendjen aktuale të subjektit në mjedis në të cilin kërkon të hyjë, edhe pse futet përkohësisht;

- leja duhet të favorizojë kultivimin e interesave të të afërmeve, të punës dhe ato kulturore.

Kohëzgjatja e përgjithshme e garantuar nuk mund të kalojë dyzetë e pesë ditë për çdo vit të kryerjes së dënimit. Çdo leje e veçantë nuk mund të ketë më shumë se pesëmbëdhjetë ditë rresht (duke përfshirë kohën e udhëtimit për të arritur vendin e lejes dhe kthimin në Institut). Edhe në këtë rast, si në lejet e nevojshme, Gjykatësi urdhëron masat e nevojshme dhe të përshtatshme. Për raste vonese të hyrjes në burg ose mungesa e hyrjes (arratisja) normativa është e njëjtë.

Vendimi për dhënien ose anulimi i lejes është protestueshëm, nga PM (Prokurori) dhe i interesuari në Gjykatën e Mbikëqyrjes.

- Liri e kontrolluar (artt. 53 e 56 I. 689/81)

Jepet nga Gjyqtari Mbikëqyrës.

Liria e kontrolluar është një metodë e zëvendësimit burgosjes dhe përfshin:

- ndalim largimi nga komuna e banimit, mund të ketë variante leje largimi vetëm për motive pune e familjeje;

- Detyrimi për tu paraqitur një herë në ditë në Zyrën e Sigurisë Publike;

- Ndalim për mbajtje arme;

- pezullimi i patentës së shoferit, mund të ketë variante leje vetëm për motive pune;

- tërheqja e pasaportës dhe dokumenteve për udhëtim jashtë vendit.

Ky regjim vlen edhe për ata të cilët duhet të paguajnë gjoba të gjyqeve penale (gjobat administrative, shpenzimet gjyqësore, etj) dhe nuk janë në gjendje t'i paguajnë.

Zëvendësimi i pagesës me një numër të caktuar të ditëve

(një ditë dënim vlerësohet 38,00 euro) përcaktohet nga Gjykatësi Mbikëqyrës në mënyrë të pavarur dhe jo me kërkesë të palës së interesuar.

- Shlyerja e borxhit (Remissionë del debito)

Shpenzimet e drejtësisë (procedurale dhe mirëmbajtjen në burg), madje edhe gjobat, mund të shlyhen, me kërkesë të të interesuarit, nga Gjyqtari Mbikëqyrës, personave që plotësojnë dy kërkesa:

